



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**BORDI  
VENDIM**

**Nr. 69, Datë 10.05.2019**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TERNA ENERGY TRADING” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 10.05.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Terna Energy Trading” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 302 Prot., datë 17.04.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, mm gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat a”, “b”, “c” dhe “d” ) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, **neni 9, pika 2, gërma “d”, “e”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë) dhe (Struktura e ndërtimit të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit (në përputhje me veprimtarinë për të cilën kërkohet licenca).

Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1 të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, t’i paraqesë ato brënda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**